

VENDIM
Nr.114, datë 1.10.2008

**PËR NDRYSHIMIN E KUSHTEVE TË LICENCËS PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA**

Në mbështetje të neneve 9, 15 dhe 19, pika 2, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.10.2008, mbasi shqyrtoi propozimin për ndryshimin e kushteve të licencës për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a.,

dhe konstatoi se:

- OSSH sh.a. është licencuar nga ERE për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.8, datë 25.1.2008 “Për dhënien e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike shoqërisë OSSH sh.a.”.

- Modeli i tregut të energjisë elektrike i miratuar nga Këshilli i Ministrave parashikon në pikën 7, rolin e ERE-s, e cila duhet të procedojë me rishikimin e akteve nënligjore që lidhen me funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

- Me vendimin nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve miratoi rregulloren për procedurat e licencimit, në të cilën afati i vlefshmërisë së licencës për aktivitetin e shpërndarjes është në harmoni me afatin e vlefshmërisë së licencës të aktivitetit të shpërndarjes të përcaktuar në modelin e licencës për këtë aktivitet.

- Me vendimin nr.69, datë 24.6.2008, Bordi i Komisionerëve ka miratuar licencën për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Ligji për sektorin e energjisë elektrike i atribuon ERE-s të drejtën që me iniciativën e vet të ndryshojë kushtet e një licence kur ka ndryshim në kuadrin ligjor,

për gjithë sa më sipër dhe me qëllim që aktet nënligjore të miratuara nga ERE në funksion të implementimit të modelit të tregut të energjisë elektrike, të reflektohen edhe në ushtrimin e aktivitetit nga subjektet e licencuara, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, OSSH sh.a. është subjekt i kushteve të licencës së miratuar nga ERE me vendimin nr.69, datë 24.6.2008 “Për miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta